



**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI  
PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK  
NË PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN**

**Kompanisë ONE Albania sh.a**  
Stacioni, 'Fushë-Buall 0900' dhe  
Fushë-Buall 1426'

**Elbasan, Qershor 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

Nr. 3559/Prot.

Elbasan, më 22.06.2026

## RELACION

### PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR PUBLIK

Për vendosjen e stacionit të antenës telefonike të lëvizëshme me kod 'Fushë-Buall 0900' dhe 'Fushë-Buall 1426'

#### *Të nderuar Këshilltar!*

Struktura e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim kërkesën e kompanisë "ONE Albania" sh.a me nr. 387 prot., datë 06.03.2026 të bashkisë Elbasan, "Për marrjen në përdorim me kontratë qiraje të 0,005 ha dhe 0.0205 ha fond pyjor në EP "Polis-Vasjan" -Për vendosjen e stacionit të telefonisë së lëvizëshme me kod "Fushë-Buall 0900" dhe "Fushe-Buall 1426" ZK 1672, e gjeti ato në përpuethshmëri me udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:

- Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligjit nr.57/2020, dt. 30.4.2020 "Për pyjet",
- Ligjit nr.8318, dt. 1.4.1998 "Për dhënie me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar (neni '13', '16'),
- Vendimit të Këshillit të Ministave nr.433 dt.8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...", i ndryshuar me VKM nr.684, dt.2.9.2020.
- VKM nr.559, datë 29.07.2022 'Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".
- Parimeve bazë të Silvikulturës,
- Listën e kuqe të florës dhe dhe faunës së egër.

Në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "ONE Albania" sh.a, plan-vendosjes së stacionit që do të rinovohet sipas lejeve përkatëse nga institucionet qendrore, referuar planit të Mbareshtimit të Pyjeve dhe Kullotave të ekonomisë pyjore "Polis-Vasjan" dhe regjistrin kadastral, rezulton së antenat ndodhen në n/ngastrën pyjore nr. 68a dhe 37d, transferuar sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...", i ndryshuar në pronësi të Bashkisë.

Antenat nuk dëmtojnë ekosistemin, specie të rralla të rëndësisë të veçantë dhe habitate në rrezik zhdukje.

Nuk ndikojnë në treguesit biologjikë, silvikulturorë dhe në infrastrukturën e zonës.

Nuk çenojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike të llojeve drusore.

Sipërfaqja pasuri publike që preket, nuk është objekt pretendimi për rikthimin e pronës, nuk është konfirmuar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave.

Në këto ngastra nuk janë bërë studime dhe projekte, objekt tjetërsimi të fondit pyjor dhe kullor publik.

Antenat e ndërtuara, nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesor të ngastrave.

### **Përfundime:**

- *Nga analiza e të dhënave të mësipërme, në zbatim të dispozitave ligjore, Ligjit nr. 8318, dt. 1.4.1998 "Për dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar (neni '13' dhe '16'), ligjit nr.57/2020 dt.30.4.2020 "Për pyjet", si dhe akteve tjera ligjore e nënligjore në fuqi,*

### ***Arsye të j m ë:***

***Propozimi për dhënien në përdorim të 0.005 ha, me nr. ngastra 68/a "Fushë-Buall 0900" dhe 0.0205 ha, me nr. ngastra 37/d "Fushë-Buall 1426" (sipërfaqe toke ku janë instaluar antenat telefonike të lëvizëshme).***

### **Bashkëlidhur këtij relacioni gjeni materialin plotësues, i cili përmban:**

1. Sipërfaqen pyjore publike, të shprehur në (ha), në shkallën 1:25 000, koordinata (gjatësi dhe gjërësi gjeografike, metrike) sipas sistemit 'KRGJSH'.
2. Treguesit identifikues të n/ngastrës, bazuar në të dhënat e regjistrin kadastral pyjor dhe kullor si dhe Planit të Inventarizimit, identifikimin sipas listës së pronave, ekonomia, n/ngastra, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, treguesit kadastralë, etj.

3. Treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrale të pyjeve dhe kullotave bazuar në vlerën dysHEME të qerasë për ha/vit, të përcaktuar me VKM-në nr. 559 datë 29.7.2022 “për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim/shfrytëzim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

Sa sipër, *kërkojmë nga ana Juaj, miratimin për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore për një periudhë 9- vjeçare.*

Bashkëlidhur këtij relacioni gjeni studimin e detajuar, të dhëna teknike për ngastrën, fragmente të hartave pyjore dhe ortofoto.

**KRYETARI**  
Gledian Llatja

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
Klaudia Krasnika



*Konceptoi:* A. Bitri

*Tranoi:* J. Bodurri

*Miratoi:* E. Hazizolli



BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

**PASQYRË E PËRMBLEDHËSE E SIPËRFAQEVE PYJORE  
PËR VENDOSJE ANTENE TELEFONIKE TË LËVIZËSHME**

Nr	Ekonomia pyjore	Niveli i pasurisë	Qëllimi i përdorimit parashikuar në VKM Nr.559, dt.29.09.2022	Tarifa dysheme për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor VKM Nr.559, dt.29.07.2022				Linjë (km)	Vlera gjithësej lekë/vit	Shënim
				Sip. që propozohet të jepet në përdorim (ha) dhe vlera lekë/vit		Përdorim rrugë për lidhjen e sipërfaqes në përdorim, me rjetin rrugor ekzistues (km)				
				Sip.ha.	Vlera lekë	Rugë lidhëse km	Vlera lekë/vit			
1.	Polis-Vasjan	68/a	Për vendosje antene telefonike të lëvizëshme	0,005	8,000,000	0.0	0.0	40,000		
2	Polis-Vasjan	37/d	Për vendosje antene telefonike të lëvizëshme	0,0205	8,000,000	0.0	0.0	164,000		
Shuma gjithësej:				0,0255				204,000		

SPECIALISTI I KADASTRËS

Aurora Bitri

PËRÇJEGJËSI SEKTORIT

Jakov Podurri

DREJTORI

Eraldo Hazizolli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK  
PROJEKT-V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2026

**“PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM”**

**Antenë telefonisë së levizëshme**

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”.Te ligjit nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenin 25 pika 1
- VKM nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik.

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **0,005(zero presje zero zero pesë)ha**,me nr.ngastre 68/a,ekonomia pyjore Polis-Vasjan dhe **0,0205(zero presje zero dy zero pesë)ha**,me nr.ngastre 37/d,ekonomia pyjore Polis-Vasjan “për antenë telefonisë së levizëshme”sipas tabelës bashkangjitur këtij vendimi me një afat 9 (nëntë) vjeçar nga lidhja e kontratës.
2. Vlera vjetore rrysheme e konkurimit për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të jetë sipas studimit teknik ekonomik dhe VKM nr.559 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.
3. Nga koha për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë prane ASHPR.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Elsid Zyma**

**KRYETAR**

**Lutfi Lala**

Konceptoi: *Aurora Bitri*

Pranoi: *Jakov Bodurri*

Miratoi: *Eraldo Hazizolli*

Drejtoria Juridike: *Elba Arapi*

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

Zbardhur me datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ 2026



BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PYJORE, BUJQËSORE, VETERINARE DHE MJEDISORE

**PËRMBLEDHËSE**  
**PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM**  
**“Antenë tel. lëvizëshme”**

Nr.	Ngastra	Ekonomia pyjore	Përdorimi territorit	Qëllimi i dhënies në përdorim	Sipërfaqe në përdorim, (Ha)		
					Ha	lekë/ha/vit	lekë
1	68/a	Polis-Vasjan	Pyll(shkurre)	Antenë tel. lëvizëshme	0,005	8 000 000	40 000
2	37/d	Polis-Vasjan	Pyll(shkurre)	Antenë tel. lëvizëshme	0,0205	8 000 000	164 000
<b>TOTALI</b>					<b>0,0255</b>		<b>204 000</b>


**Specialisti i Kadastrës**

Aurora Bitri



**Pergjegjesi Sektorit Menaxhimit**

Jakov Bodurri



**DREJTORI**

Eraldo Hazizolli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 3534 Prot

Elbasan më \_\_\_\_/06/2026

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MAJ 2026

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar , ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**Propozojmë:**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin MAJ 2026 gjithsej 80 familje me një fond gjithsej 250.000 lekë .  
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .  
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Përgj sektori  
Pranoi: Dr Përgjithshem

M.Duka  
D.Shuli

Zv/kryetari

Asim Sula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Elbasan më \_\_\_\_/06/ 2026

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/06/ 2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MAJ 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/06/2026

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin MAJ 2026 për 80 familje me një fond prej 250.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori  
Miratoi: Dr Përgjithshëm  
Drejtor Dr Juridike  
Drejtor Dr Finance  
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka  
D.Shuli  
E.Arapi  
A.Merkja  
A.Sula

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**  
Elsid Zyma

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**  
Lutfi Lala



**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL**  
**SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE**  
**DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR**

**INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN MAJ**  
**2026**

**I. Ndhimja ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2026**

Maj	247 familje	fondi	1.148.741
Prill	243 familje	fondi	1.128.164

Për muajin Maj 2026 kemi familje më pak se muaji paraardhës që propozojme të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi është 35.023 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Eglentina Sene (riaplikon ne sistem)
2. Enkelejda Luli (riaplikon ne sistem)
3. Fatmir Ylli (riaplikon ne sistem)
4. Flora Fyshku (riaplikon në sistem)
5. Genc Çaraoshi (riaplikon në sistem)
6. Hamide Myrtezaj (riaplikon në sistem)
7. Majlinda Begolli (riaplikon ne sistem)
8. Mimosa Zeneli (riaplikon ne sistem)
9. Pranvera Korra (riaplikon ne sistem)
10. Sara Brahja riaplikon ne sistem)
11. Valbona Kofsha (riaplikon ne sistem)
12. Violeta Janku (riaplikon ne sistem)
13. Melisa Staka (larguar jashte shtetit)
14. Xhevahir Korra (perfitues ne sistem)
15. Ismail Muça (merr pension)
16. Ibrahim Limanllari (nuk paraqitet)
17. Artur Gjini (riaplikon ne sistem)
18. Sali Biba (merr pension)
19. Mbaresë Biba (nuk paraqitet)
20. Rozeta Boka (perfituese ne sistem)

## II. Ndhimja ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Maj 2026

Prill	78 familje	fondi	240.000
Prill	78 familje	fondi	244.000

Për muajin Prill 2026 kemi 1 familje më shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.


Fondi i shpenzuar është 4.000 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

1. Zymbyle Lumani (nuk terheq leket)
2. Ina Buzhani (nuk terheq leket)
3. Sadik Llapushi (aplikon ne sistem)
4. Ferdinand Meta (aplikon ne sistem)
5. Behar Samurri (aplikon ne sistem)
6. Bashkim Muça (aplikon ne sistem)


**Konceptoi**

**Specialiste Ermira Dika**



**Përgjegjëse Sektori**

**Miranda Duka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr.Prot 3533

Elbasan më 18/06/2026

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin MAJ 2026  
KËSHILLIT BASHKIAK**

*Të nderuar Këshilltarë,*

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin MAJ 2026 ,  
247 familje me një fond prej 1.148.741 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Përgj Sektori  
Pranoi: Dr Përgjithshëm

M.Duka  
D.Shuli

ZV/ KRYETARI

Asim Sulaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Elbasan më \_\_\_\_/06/2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_/06/2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MAJ 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/06/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Social

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **MAJ 2026** për 247 familje me një fond prej **1.148.741** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori  
Pranoi : Dr Përgjithshëm  
Drejtor Dr Juridike  
Drejtor Dr Finance  
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka  
D.Shuli  
E.Arapi  
A.Merkja  
A.Sula

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Elsid Zyma**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi Lala**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 2189 prot

Elbasan , më 20.04.2026

**Relacion**

Për miratimin e akt-dhurimit të mjetit teknologjik (AUTOCARRO PER PASTRIMIN RRUGE SCANIA P114 VP1999) me tonazh 12.8 ton.

**Këshilli Bashkiak**

**Këtu**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak ,

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së pastrimit dhe përfocimit të kapaciteteve logjistike të Bashkisë Elbasan për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane Shoqëria Emir Shpk ka shprehur dëshirën për ti dhuruar Bashkisë një mjete teknologjik në shërbim të komunitetit në zonat Rurale.

Ky akt-dhurimi vjen si mbështetje për përmbushjen me efektive të shërbimeve publike , duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në mbrojtjen e mjedisit në territorin e bashkisë sonë.

Vlera e mjetit për efekt kontabilizmi është 682.326 lekë sipas dokumentave shoqëruese.

Përdorimi i mjetit do të bëhet nga Agjensia e Shërbimit Publik Rural për shërbimin e pastrimit në 12 Njësitë Administrative dhe do të administrohet në përputhje me aktet në fuqi për menaxhimin e aseteve publike.


Përsa në sipër ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim **akt-dhurimin e mjetit teknologjik për pastrimin e rrugëve** , me të dhënat si më poshtë :

- Lloji i mjetit : kamion teknologjik për pastrimin e rrugëve
- Tonazh: 12.8 ton
- Gjendja teknike : Mjet funksional , në gjendje pune të mirë
- Qëllimi i dhurimit: Për përdorim të dedikuar për shërbimin e pastrimit në Bashkinë Elbasan
- Dhuruesi: Shoqëria 'EMIR' SH.P.K

**Kërkojme nga Këshilli Bashkiak Elbasan miratimin e këtij akt-dhurimi.**

Konceptoi: P.S.Juridik: I.Tavanxhiu  
Pranoi : Dr. Pergj.Ashpr: A.Cenolli

Me urdhër e porosi  
ZV/KRYETAR  
Klaudja Krasnika



**KRYETARI**  
Gledian Llatja



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**

Nr. \_\_\_\_ prot

Elbasan , më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**Kontratë Dhurimi**

Lidhur sot më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026 , midis ,

- Shoqërisë 'EMIR'SH.P.K me NIPT K63319202Q , përfaqësuar nga administratori i saj z.Hiqmet Deda , me cilësinë e dhuruesit
- Bashkisë Elbvasan , përfaqësuar nga Kryetari i saj z.Gledian Llatja , me cilësinë e pranuesit të dhurimit

**Kushtet Paraprake**

Duke qënë se:

- Bashkia Elbasan , ka në funksionet e veta të parashikuara nga ligji 139/2015 'Për vetqeverisjen vendore', edhe shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.
- Shoqëria 'EMIR' SH.P.K. , disponon një mjet teknologjik të largimit të mbeturinave dhe dëshiron t'ia dhurojë Bashkisë Elbasan , në funksion të shërbimit të pastrimit dhe largimit dhe mbeturinave të territorit në juridiksion të saj , palët bien dakort sa vijon:

**Neni 1**

**Objekti i kontratës**

Kjo kontratë ka si objekt , krijimin e marrëdhënieve të palëve në lidhje me dhurimin e një mjeti teknologjik për pastrimin dhe largimin e mbeturinave të cilin dhuruesi , shoqëria 'EMIR' SH.P.K. ia dhuron Bashkisë Elbasan , në funksion të shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbeturinave të territorit në juridiksion të saj dhe lidhet bazuar në ligjin 139/2015 'Për vetqeverisjen vendore' , ligji10296 datë 08.07.2010 'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin' , nenet 761 e vijues të Kodit Civil.

**Neni 2**

**Mjeti dhe karakteristikat e tij**

Mjeti që dhurohet është makinë teknologjike për pastrimin e rrugëve(AUTOCARRO PER PASTRIMIN RRUGE SCANIA P114 VP1999) ,me numer shasie XLEP4X20004410437 dhe me karakteristika teknike të shprehura në dokumentacionin e mjetit , që janë pjesë e kësaj kontrate.

**Neni 3**

**Kushtet e dhurimit**

Shoqëria 'EMIR' SH.P.K. ia dhuron Bashkisë Elbasan mjetin e përcaktuar në nenin 2 , në gjëndje pune dhe pa asnjë kundërshtëpërblim dhe Bashkia Elbasan e pranon mjetin në gjëndjen që është. Vlera e deklaruar e mjetit , sipas dokumentacionit shoqërues të tij është **682.326lekë**.

#### **Neni 4**

##### **Dorëzim i mjetit**

Dorëzim i mjetit do të kryhet në ambjentet e Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale, Bashkisë Elbasan , në prani të përfaqësuesve të kësaj Agjensie dhe atyre të dhuruesit , të cilët hartojnë dhe nënshkruajnë proces-verbalin e dorëzimit.

#### **Neni 5**

##### **Dokumentaconi dhe pronësia e mjetit**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe marrjen në dorëzim sipas nenin 4 , pronësia mbi mjetin i kalon Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale, Bashkisë Elbasan , e cila është e detyruar të bëjë të gjitha regjistrimet e mjetit kudo qoftë e nevojshme.

#### **Neni 6**

##### **Tërësia dhe Interpretimi i kontratës**

Kjo kontratë do të interpretohet duke kosideruar afatet dhe kushtet e saj në tërësi. Në çdo rast, secili nën apo formulim që do të krijojë paqartësi do të vlerësohet në kontekstin e të gjithë kontratës dhe në lidhje me qëllimet që kanë nxitur të dyja palët për të lidhur këtë kontratë. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

#### **Neni 7**

##### **Dispozita të fundit**

Palët përgjigjen për respektimin dhe realizimin e kësaj kontrate.

Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë mes palëve çdo shtesë apo ndryshim i kësaj kontrate bëhet vetem me miratimin në formë të shkruar të të dyja palëve në kontratë.

Kjo kontratë hartohet në 4(katër) kopje, nga 2(dy) kopje origjinale për secilën palë , të cilat pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.

#### **Neni 8**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë dhurimi hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët dhe miratimit në Këshillin Bashkiak.

Për shoqërinë 'EMIR' SH.P.K.

Administratori

Hiqmet Deda

Për Bashkinë Elbasan

Kryetari

Gledian Llatja

Konceptoi: P.S.Juridik: I.Tavanxhiu

Pranoi : Pergj.Ashpr: A.Cenolli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. \_\_\_\_ Prot

Datë \_\_. \_\_. 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_. \_\_. 2026

“Për miratimin e akt-dhurimit të mjetit teknologjik (AUTOCARRO PER PASTRIMIN RRUGE SCANIA P114 VP1999) me tonazh 12.8 ton”

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54, ”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,,”

Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr. \_\_\_\_ datë: \_\_\_\_\_

VENDOSI :

1. Të miratojë kontratën e dhurimit të një makine teknologjike për pastrimin e rrugëve (AUTOCARRO PER PASTRIMIN RRUGE SCANIA P114 VP1999) ,me numer shasie XLEP4X20004410437, nga shoqëria ‘EMIR’SH.P.K sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Pronësia e mjetit do ti kaloj Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale, Bashkia Elbasan.
3. Ngarkohet Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: P.S.Juridik: I.Tavanxhiu  
Pranoi : Dr.Pergj.Ashpr: A.Cenolli  
Miratoi : Dr. Dr. Juridike: A.Hoxha  
Konfirmoj:Zv.Kryetare: K.Krasnika

Sekretari i Këshillit Bashkiak

ELSID ZYMA

Kryetari i Këshillit Bashkiak

LUTFI LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 3255 Prot.

Elbasan, më 19.06.2026

## RELACION

### PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË SUBJEKTEVE QË KËRKOJNË TË NJIHEN SI “POSEDUES JOPRONARË”

#### *Të nderuar Këshilltar!*

Në mbështetje të ligjit nr. 20/2025 “Për paketën e maleve”; ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; VKM nr. 625, datë 29.10.2025 “Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Elbasan” si dhe udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e Bashkive”. Bashkia Elbasan ka nxjerr urdhërin nr. 232, datë 30.03.2026 ‘Për ngritjen e grupit të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkuar, për tu njohur si Posedues Jopronarë’.

Në zbatim të urdhërit të sipërcituar Grupi i Punës kreu detyrat e poshtëcituar brenda afatit ligjor të caktuar në urdhër:

- Pas regjistrimit të kërkesës grupi i punës kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në çdo element të tij.
- Grupi i punës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesave nisi evidentimin në terren të sipërfaqeve, objekt të kërkesave të administruara, duke verifikuar gjendjen e posedimit të pasurisë nga subjektet, për të cilën mban procesverbalin përkatës.
- Grupi i punës përgatiti dhe dërgoi të gjithë korrespondencën e duhur me ASHK dhe ATP, ku kërkoi informacion sipas pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 20/2025 “Për paketën e maleve”.
- Grupi i punës afishoi kërkesat për pasuritë apo pjesët të cilat përmbushnin kriteret, në ambientet e saj, në një mjedis tjetër publik (*Njësitë Administrative përkatëse*) brenda territorit të zonës dhe në faqen zyrtare të saj për një periudhë kohore prej 45 (dyzet e pesë) ditësh.

Pas përfundimit të afatit të njoftimit përmes afishimit publik, grupi i punës:

- Hartoi listat përfundimtare të subjekteve që kanë paraqitur kërkesë për njohje si posedues jopronarë, si dhe planin e rievimit për sipërfaqet përkatëse;
- Po paraqet dokumentacionin përkatës për miratim pranë Këshillit Bashkiak, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të njoftimit publik për listat pjesore që kanë kaluar afatin 45 (dyzet e pesë) ditor;

Grupi i punës ka ndjekur me rigozitet të gjithë hallkat ndërlidhëse të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2026 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit dhe procedurën administrative për njohjen si posedues jopronarë” të Bashkisë Elbasan.

Dhe nga grumbullimi, bashkëpunimi, analizimi dhe verifikimi në terren të pretenduesve që synojnë të shpallen posedues jopronar si dhe pas kalimit të afatit 45 (dyzet e pesë) ditor të afishimit publik për një pjesë të subjekteve, arriti në përfundimin që të propozoj për shpalljen si posedues jopronar listën emërore të pjesshme të shoqëruar me plan-rilevimet dhe dokumentacionet përkatëse sipas renditjes së mëposhtme:

## ➤ **Njësia Administrative Gjinar, Elbasan**

### 1. **Anxhela Sinani**

Anxhela Sinani ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr PM-2026-07049463719-KS ku ka bashkangjitur dokumentet si Deklarata noteriale banorësh për posedimin, planvendosje nga topograf i licensuar, mandate pagesa taksash, vërtetim nga njësia administrative Gjinar dhe kryetari Fshatit Gjinar për mënyrën e posedimit. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 16/04/2026 nga Ashk ku citon se pasuria pozicionohet në pasurinë nr 241 dhe figuron e llojit pyll e rregjistruar në emër të Bashkisë Elbasan, ndërsa ATP me shkresën nr 2085/1 prot. datë 09/04/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje kthim apo kompesim prone. Gjithashtu është kryer edhe verifikimi në terren nga grupi punës ku ka vërejtur që kjo pronë është e ruajtur nga familja e Anxhelës si dhe kjo sipërfaqe ndodhet ngjitur me banesën dhe pronat e familjes së saj. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 20/04/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta.

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

### 2. **Viktor Qosja**

Viktor Qosja ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr PM-2026-06022851626-HG ku ka bashkangjitur dokumentet si planvendosje nga topograf i licensuar, foto, vërtetim nga njësia administrative Gjinar, kryetari Fshatit Gjinar për mënyrën e posedimit dhe projekt ide 3D. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 31/03/2026 nga Ashk ku citon se pasuria pozicionohet në pasurinë nr.25 , figuron e llojit kullotë e rregjistruar në emër të Bashkisë Elbasan, ndërsa ATP nr 1297/1 prot. datë 19/03/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje kthim apo kompesim prone. Gjithashtu është kryer edhe verifikimi në terren nga grupi punës ku ka vërejtur që kjo kullotë e pastruar nga gurët pretendohet nga familja Qosja. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 20/04/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta .

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

## **Konkluzioni**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të subjekteve kërkues dhe bashkëpunimit të ngushtë me autoritetet qendrore dhe vendore si dhe pas kalimit të procedurave administrative të afishimit publik në ambientet e Njësive Administrative dhe faqen zyrtare të Bashkisë, grupi i punës ndoqi të gjithë procesin e konsultimit publik brenda afatit 45 ditor dhe administroi me prioritet të gjithë ankesat dhe pretendimet sipas rastit (*nëse kishte*) për subjektet që pretendojnë të njihen si posedues jopronar. Pas kalimit me sukses të kësaj faze në mbështetje të pikës 3, neni 10 i ligjit nr. 20/2025 'Për paketën e maleve' i propozon Këshillit Bashkiak të miratoj listën përkatëse të cituar mësipër për subjektet që kanë kërkuar të njihen si 'posedues jopronar'.

**Bashkëlidhur këtij relacioni gjeni listën e detajuar me subjektet kërkues që plotësojnë kriteret për t'u njohur si posedues jopronar, sëbashku me plan rilevimet e detajuara të hartuara nga gjeodet te licensuar.**

**KRYETARI**  
**Gledian Llatja**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**

**Asim Sula**

*Konceptoi*

K. Ruçi

K. Totoshi

E. Mihal

G. Kerri

*Konfirmoi*

Sh. Çullhaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

**LISTA EMËRORE E SUBJEKTEVE QË KËRKOJNË TË NJIHEN SI “POSEDUES JOPRONARË”**

Nr.	Emer / Mbiemer	Sipërfaqja (ha)	Njësia Administrative
1	Anxhela Sinani	0.5714	Gjinar
2	Viktor Qosja	0.3	Gjinar

*Shënim: Subjektet kërkues të mësipërm që kërkojnë të njihen si ‘posedues jopronar’ kanë kaluar të gjithë procedurat administrative dhe konsultimet publike 45 -ditore dhe për sipërfaqet që ata pretendonjë nuk ka pasur ankesa.*

**GRUPI I PUNËS**

Klajdi Ruçi

Elior Mihali

Gentiana Kerri

Krisi Totoshi

926/  
24.3.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1297/prot.  
11

Tiranë, më 19.03. 2026

Lënda: Kthim Përgjigje

**BASHKISË ELBASAN**  
Rruga: "Qemal Stafa", Elbasan

Në përgjigje suajës nr. 926 prot, datë 20.02.2026, protokolluar pranë ATP-së me nr. 1297 prot, datë 03.03.2026, me anë të së cilës kërkon informacion nëse ka vendime për njohje, kthim apo kompensim-prone për sipërfaqet e konturuara në materialin hartografik bashkëlidhur, Bashkia Elbasan, ju bëjmë me dije se:

Referuar sistemit WEB-GIS pranë ATP-së, nga të dhënat e pasqyruara deri më tani, rezulton se janë trajtuar më vendime, parcelat si më poshtë vijon:

- Parcela A me sipërfaqe prej 1270 m<sup>2</sup> dhe parcela A me sipërfaqe prej 1761 m<sup>2</sup>, të ndodhura në ZK. 1742, Njësia Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan, janë trajtuar me vendimin nr. 30, datë 02.03.2026 të ish KVKKP-së qarku Elbasan, në emër të subjektit Anastas Shqau, ishfuqizuar me vendimin nr. 135(3), datë 08.07.2008 të ish ZRKKP-së qarku Elbasan, lënë në fuqi me vendimin nr. 282, datë 26.03.2008 të AKKP-së.
- Parcela B me sipërfaqe prej 1270 m<sup>2</sup> dhe pasuritë me sipërfaqe prej 3544 m<sup>2</sup>, 1550 m<sup>2</sup> dhe 1805 m<sup>2</sup> të ndodhura në ZK. 1742, Njësia Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan janë trajtuar me vendimin nr. 10, datë 15.12.2005 të ish KVKKP-së qarku Elbasan, në emër të subjektit Anastas Topi.
- Parcela B me sipërfaqe prej 2018 m<sup>2</sup>, e ndodhur në ZK. 1742, Njësia Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan është trajtuar me vendimin nr. 71, datë 25.05.2006 të ish KVKKP-së qarku Elbasan, në emër të subjektit Lazi Qosja.
- Sipërfaqja prej 4400 m<sup>2</sup>, e ndodhur në ZK. 1742, Njësia Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan është trajtuar me vendimin nr. 141 dhe nr. 142, datë 25.06.2008 të ish KVKKP-së qarku Elbasan, në emër të subjektit Nikollë Binjaku, shfuqizuar me Vendimin nr. 2505/6 datë 16.02.2009 të AKKP-së dhe vendosur mosnjohja e të drejtës së pronësisë me vendimin nr. 225, datë 13.04.2011 të AKKP-së

Ju bëjmë me dije se ATP, nuk garanton faktin nëse vendimet e sipërcituara të jenë ndryshuar gjyqësisht.


Sa i përket parcelave të tjera të konturuara në materialin hartografik bashkëlidhur, referuar sistemit WEB-GIS pranë ATP-së nga të dhënat e pasqyruara deri më tani, nuk rezultojn të ketë vendime për njohje, kthim apo kompensim prone.

Bashkëlidhur, po ju dërgojmë një kopje të vendimeve të sipërcituara, me materialin hartografik të ndodhur në dosje, gjithsej 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë.

Gjithashtu, Agjencia e Trajtimit të Pronave ju bën me dije se sistemi WEB-GIS ndodhet në proces të vazhdueshëm përditësimi dhe azhurnimi. Në çdo rast, të dhënat e pasqyruara në sistem rishikohen dhe përmirësohen sa herë që konstatohen pasaktësi apo mangësi gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, si edhe në rastet kur paraqitet kërkesë nga subjekti i interesuar.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Benard BAJAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KËRKESË PËR PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT

DREJTUAR: Z./ZJ. BASHKIA ELBASAN BASHKIA ELBASAN

Gjatë shqyrtimit të aplikimit tuaj nr. 8742 , datë 18.03.2026 u konstatua se ai nuk është i shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

→ *Victor Daj*

1. Ne pergjigje te kerkeses nr. 8742, date 18.03.2026 ju njoftojme se nga verifikimi i bere nga hartografi i ASHIK (Elbasan), sipërfaqja A (prej 3.000 m<sup>2</sup>) percaktuar nga ana juaj ne planvendosjen e dates 13.02.2026, pozicionohet mbi pasurine nr. 25, vol. 001, faq. 033, ndodhur ne zone kadasrale 2883. Pasuria eshte e llojit kullote, me sipërfaqe 1.009.794 m<sup>2</sup>. Pasuria rezulton e regjistruar ne pronesi te Bashkia Elbasan. Seksionet e te drejtave reale dhe te kufizimeve te pronesise nuk marten inskriptime domosdoshem ne baze te Ligjit nr. 111/2018.

2. Te tjera, i domosdoshem ne baze te Ligjit nr. 111/2018;

Për sa më sipër , lutemi për plotësimin e aplikimit me dokumentat e mësipërme në mënyrë që të mundësojnë ofrimin e shërbimit të kërkuar.

DREJTORI

Ester Isai

Data e lëshimit 31/03/2026

Donald

Dervisha

Digitally signed by:  
Donald Dervisha  
Date: 2026.03.31  
10:36:36 +02'00'

Ester

Isai

Digitally signed by:  
Ester Isai  
Date: 2026.03.31  
01:03:58 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Elbasan  
Date: 2026/03/31 10:36:45 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ELBASAN  
NJËSIA ADMINISTRATIVE GJINAR

Nr. 90 Prot.

GJINAR me 09/03 2026

Me kërkesë të shtetasit/es: Viktor Qosja, i/e datëlindjes 06.03.1972.  
dhe Nr. personal: H20306011R

VËRTETOJMË

Se shtetasi/a i sipërpërmendur kujdeset dhe mirëmban, në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, pasurinë/territorin me të dhënat e mëposhtëme:

Përshkrimi i pasurisë/parcelës: Elbasan-Gjinar

- Përdorues aktual: Viktor Qosja
- Forma e përdorimit: *Bujqësi / banim / kullotje / ndërtim ndihmës / djerr / pyll / tjetër*


Ky vërtetim lëshohet në bazë të të dhënave dhe dokumentacionit të administruar pranë Njesisë Administrative, si dhe verifikimeve në terren dhe nuk përbën dokument pronësie, por vetëm konfirmim të përdorimit faktik të pasurisë.

Lëshohet për t'u paraqitur pranë: Njesisë përgjegjëse për zbatimin e paketës së maleve,  
Bashkia Elbasan.

PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE GJINAR  
Administratori  
Emanuel HIDA



Adresa: Njësia Administrative Gjinar, Elbasan; Cel: 0675451320



**PLANVENDOSJE E PASURIVE TE POSEDUARA NGA Z.VIKTOR MARK QOSJA**  
**NJA GJINAR ,FSHATI PASHTRESH**  
**INDEKS HARTE : K-34-101-(248-A)**  
**PLANIRILEVIMIT: SHKALLA 1 :1000**  
**PAS A =3000m<sup>2</sup>**

KOORDINATAT E KUPIRIT TE PROGRES A  
 NE PROJEKSIONIN MRRJESH

1-X=518462.3971 Y=4541772.8602  
 2-X=518486.2818 Y=4541776.5123  
 3-X=518527.9546 Y=4541681.9840  
 4-X=518491.9294 Y=4541679.6175

FOTODRORE 2015 SHKALLA 1 :5000




PRONA SIPAS GOOGLE MAPS 2025  
**Luan Mema**  
 Mema  
 Date: 2025.03.05 21:59:09  
 +02:00

EMERTIMI	PLANVENDOSJA E RELIEVIT
VENDODHJA	ELBASAN-GJINAR
POROSITI	VIKTOR QOSJA

DATA E PERGATITES	ELBASAN ME 25/05/2025
PERGATITI	ING LUAN MEMA
	Liqenia Nr. T/0681 D.17.06.2019
	T2

FRMA



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA ELBASAN  
NJËSIA ADMINISTRATIVE GJINAR

Nr. BB Prot.

GJINAR, më 05/09 2026

Me kërkesë të shtetasit/es: **Anxhela Sinani, i/e datëlindjes 27.09.1996,**  
dhe Nr. personal: **J65927012D**

**VËRTETOJMË**

Se shtetasi/a i sipërpërmendur ka në përdorim në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, prej më shumë se 10 vite për pasurinë/territorin me të dhënat e mëposhtëme:

Përshkrimi i pasurisë/parcelës: **Elbasan-Gjinat**

- Përdorues aktual: **Anxhela Sinani**
- Forma e përdorimit: **Bujqësi / banim / kullotje / ndërtim ndihmës / djerr / pyll / tjetër**

Ky vërtetim vërehet në bazë të të dhënave dhe dokumentacionit të administruar pranë Njesisë Administrative, si dhe verifikimeve në terren dhe nuk përbën dokument pronësie, por vetëm konfirmim të përdorimit faktik të pasurisë.

Lëshohet për t'u paraqitur pranë: **Njesisë përgjegjëse për zbatimin e paketeve të maleve, Bashkia Elbasan.**

KRYETAR I FSHATIT GJINAR

Kostandin MUFARZI




PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE GJINAR

Administratori

Emanuel HIDA





**PLANVENDOSJE E PASURIVE TE POSEDUARA NGA Z.ANXHELA SIMON SINANI**  
**NJA GJINAR, INDEKS HARTE: K-34-101-(231-C)**  
**PLANIRILEVIMIT: SHKALLA 1 :2500**  
**PAS A =5714m<sup>2</sup>**

KOORDINATAT E KUPURIT TE PROJES A  
 NE PROJEKSIONIN NRRGJISH  
 1-X=516476.8747 Y=4543832.1305  
 2-X=516536.7648 Y=4543837.9960  
 3-X=516580.2443 Y=4543798.0584  
 4-X=516590.0578 Y=4543762.4681  
 5-X=516587.0825 Y=4543749.6786  
 6-X=516539.1666 Y=4543763.4178  
 7-X=516505.2823 Y=4543748.0382



FOTO AJRORE SHKALLA 2015 1:5000



PRONA SIPAS GOOGLE MAPS 2025

Digitally signed by Luan Mema  
 Date: 2025.02.19 09:31:10 +02'00'

**Luan**

ELBASAN RE 13022025	PRONA
Ing. LUAN MEMA	
Drejtori M. Trosari Dit. 13.08.2019	
T2	

EMERTIMI	PLANVENDOSJA E RELIEVIT
VENDNDODHJA	ELBASAN-GJINAR
POROSITI	ANXHELA SINANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES  
DREJTORIA VENDORE ELBASAN

DI: 16.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje.

Drejtuar: BASHKISË ELBASAN.

*Anshela Sinani*

Në përgjigje të kërkesë aplikimi nr.9748 dt:27.03.2025, në të cilin keni aplikuar për informacion zyrtar të gjendjes juridike të pasurive sipas planit të rilevimit bashkëlidhur aplikimit, bazuar në ligjin nr.114/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe ligjin nr.111/2018 "Për Kadastrën", ju informojmë se:

i. Pasuria pozicionohet pjesërisht mbi pasurinë nr.241, figuren e llojit Pyll, me sipërfaqe 36264m<sup>2</sup>, regjistruar në volum 9 faqe I, zk. 1742, fshati Gjina, bashki Elbasan, në emër të Bashkisë Elbasan.

DREJTORI

**ESTER ISAI**

Alma  
Pajova

Digitally signed by  
Alma Pajova  
Date: 2026.04.16  
03:46:45 +0200

Iri  
Nako

Digitally signed by  
Iri Nako  
Date: 2026.04.16  
03:51:32 +0200

Ester  
Isai

Digitally signed by  
Ester Isai  
Date: 2026.04.16  
03:19:36 +0200



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Elbasan  
Date: 2026/04/16 15:49:06 +0200  
K52905207B2026041615485940014

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Elbasan)

1702/  
14.4.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 2085/prot.  
1

Tiranë, më 09.04.2026

Lënda: Kthim Përgjigje

**BASHKISË ELBASAN**  
Rruga: "Qemal Stafa", Elbasan

Në përgjigje suajës nr. 1702 prot, datë 27.03.2026, protokolluar pranë ATP-së me nr. 2085 prot, datë 02.04.2026, me anë të së cilës kërkonti informacion nëse ka vendime për njohje, kthim apo kompensim prone për pasurinë A me sipërfaqe prej 5714 m<sup>2</sup>, me kërkues Anxhela Simon Sinani, ndodhur në ZK. 1742, Gjinar, Bashkia Elbasan, ju bëjmë me dije se:

Referuar sistemit WEB-GIS pranë ATP-së, nga të dhënat e pasqyruara deri më tani, nuk rezulton të ketë vendime për njohje, kthim apo kompensim prone, për pasurinë A me sipërfaqe prej 5714 m<sup>2</sup>, me kërkues Anxhela Simon Sinani, ndodhur në ZK. 1742, Gjinar, Bashkia Elbasan.

Gjithashtu, Agjencia e Trajtimit të Pronave ju bën me dije se sistemi WEB-GIS ndodhet në proces të vazhdueshëm përditësimi dhe azhurnimi. Në çdo rast, të dhënat e pasqyruara në sistem rishikohen dhe përmirësohen sa herë që konstatohen pasaktësi apo mangësi gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, si edhe në rastet kur paraqitet kërkesë nga subjekti i interesuar.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Benard PAJAZI

